

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje makineta për projektin Pilot për vjeljen e tarifës së parkimit në rrugë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Makineri dhe aparate mikroelektronike, 31712100-1.

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fond limit është: **15,322,500** (pesëmbëdhjetë milion e treqind e njëzetë e dy mijë e pesëqind) **lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Tirana Parking ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës Nr.3

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës Nr.9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e perlllogaritur e kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë sepse ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare (2021, 2022, 2023), të konfirmuara nga Administrata Tatimore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 ”Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2024 sipas afateve të maturuara/përcaktuara dhe parashikuara në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar prej njësisë të vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ka selinë. Ky kriter plotësohet me paraqitjen e vetedeklarimit në fazën e ofertimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e TaksaveVendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar.

Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas sipas shtojcës përkatëse të DST-se.Operatori ekonomik i kualifikuar i pari ne klasifikim duhet te dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejten të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës
 - Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

- 2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të plotësojë standartet e mëposhtme të çertifikimit për pajisjen e ofertuar të tipit parkimetër:
Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 për objektin e prokurimit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nënenet 36 dhe 79 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nënenet 40, pika 8 dhe 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mundësitë për ekzekutimin e objektit të prokurimit dhe siguron cilësinë e mallrave objekt prokurimi, si dhe vlen në vazhdimësi për realizimin e kërkesave të AK nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemeve përkatëse.

Vendosja e çertifikatave të kërkuara është e nevojshme që operatorët ekonomikë të jenë të çertifikuar nga organizata kombëtare/ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit, sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi to. Këto standarde aplikohen për kompani të ndryshme përfshirë këtu edhe shoqëritë që ushtrojnë aktivitet tregtar, pavarësisht nëse janë prodhuese apo importuese, madhësisë apo kompleksitetit që ato kanë ose fushës së veprimtarisë që ato ushtrojnë.

- 2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deklaratë konformiteti CE për pajisjet e ofertuara.
- 2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës që pajisja e tipit parkimetër duhet të plotësojë të gjitha standartet Europiane si më poshtë:
- ✓ EN 62368-1:2014/A11:2017
 - ✓ EN 55032:2015/EC:2016
 - ✓ EN 55035:2017
 - ✓ EN 61000-3-2:2014
 - ✓ EN 61000-3-3:2013
 - ✓ 2014/35/UE, 2014/30/UE
 - ✓ EN 12414: 2020

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nënenet 36 dhe 79 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nënenet 40, pika 8 dhe 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mundësitë për ekzekutimin e objektit të prokurimit dhe siguron cilësinë e mallrave objekt prokurimi, si dhe vlen në vazhdimësi për realizimin e kërkesave të AK nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemeve përkatëse.

Vendosja e çertifikatave të kërkuara është e nevojshme që operatorët ekonomikë të jenë të çertifikuar nga organizata kombëtare/ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit, sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi to. Këto standarde aplikohen për kompani të ndryshme përfshirë këtu edhe shoqëritë që ushtrojnë aktivitet tregtar, pavarësisht nëse janë prodhuese apo importuese, madhësisë apo kompleksitetit që ato kanë ose fushës së veprimtarisë që ato ushtrojnë.

2.3.4 Pajisja e tipit parkimetër duhet të jetë e testuar për rezistencë ndaj goditjeve sipas minimalisht standartit IK09 .

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenet 36 dhe 79 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenet 40, pika 8 dhe 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mundësitë për ekzekutimin e objektit të prokurimit dhe siguron cilësinë e mallrave objekt prokurimi, si dhe vlen në vazhdimësi për realizimin e kërkesave të AK nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemeve përkatëse.

Vendosja e çertifikatave të kërkuara është e nevojshme që operatorët ekonomikë të jenë të çertifikuar nga organizata kombëtare/ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit, sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi to. Këto standarde aplikohen për kompani të ndryshme përfshirë këtu edhe shoqëritë që ushtrojnë aktivitet tregtar, pavarësisht nëse janë prodhuese apo importuese, madhësisë apo kompleksitetit që ato kanë ose fushës së veprimtarisë që ato ushtrojnë.

2.3.5 Pajisja e tipit parkimetër duhet të jetë e testuar për rezistencë ndaj pluhurave dhe ujit sipas minimalisht standartit IP54.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenet 36 dhe 79 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenet 40, pika 8 dhe 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mundësitë për ekzekutimin e objektit të prokurimit dhe siguron cilësinë e mallrave objekt prokurimi, si dhe vlen në vazhdimësi për realizimin e kërkesave të AK nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemeve përkatëse.

Vendosja e çertifikatave të kërkuara është e nevojshme që operatorët ekonomikë të jenë të çertifikuar nga organizata kombëtare/ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit, sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi to. Këto standarde aplikohen për kompani të ndryshme përfshirë këtu edhe shoqëritë që ushtrojnë aktivitet tregtar, pavarësisht nëse janë prodhuese apo importuese, madhësisë apo kompleksitetit që ato kanë ose fushës së veprimtarisë që ato ushtrojnë.

2.3.6 Pajisja e tipit parkimetër duhet të jetë e testuar sipas Certifikimit UNI EN 14450:2018 për sigurinë e kasafortës së parkimetrit kundër vjedhjes, goditjeve, vandalizmit dhe hapjes me forcë me objekte të forta.

Këto çertifikime duhet të vërtetohen me anë të paraqitjes së dokumentacionit të testimit nga laborator i çertifikuar për të njehsuar këto standarte.

Në rast se O.E nuk është prodhues i pajisjeve në fjalë, ai duhet të paraqesë dokumentacionin e mësipërm nga prodhuesi i pajisjeve, të përkthyer dhe noterizuar.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nën 36 dhe 79 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nën 40, pika 8 dhe 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mundësitë për ekzekutimin e objektit të prokurimit dhe siguron cilësinë e mallrave objekt prokurimi, si dhe vlen në vazhdimësi për realizimin e kërkesave të AK nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemeve përkatëse.

Vendosja e çertifikatave të kërkuara është e nevojshme që operatorët ekonomikë të jenë të çertifikuar nga organizata kombëtare/ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit, sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi to. Këto standarde aplikohen për kompani të ndryshme përfshirë këtu edhe shoqëritë që ushtrojnë aktivitet tregtar, pavarësisht nëse janë prodhuese apo importuese, madhësisë apo kompleksitetit që ato kanë ose fushës së veprimtarisë që ato ushtrojnë.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë në gjuhën shqipe ose në rastin kur është në gjuhë angleze ose tjetër, e përkthyer dhe e noterizuar për çdo produkt, ku të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në ofertë dhe specifikimet teknike, për të gjetur pasqyrim të plotë për të gjitha parametrat teknikë të produktit (*shih specifikimet teknike*) të kërkuara nga autoriteti kontraktor dhe të ofruara nga operatori ekonomik.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nën 77, pika 4 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar si dhe nën 40, pika 6 gërma ”b” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

b) fotografitë apo katalogët teknikë

Paraqitja e katalogëve është e nevojshme për të verifikuar përputhshmërinë e produkteve të ofertuara nga OE me specifikimet teknike të AK me qëllim realizimin e kontratës me sukses.

2.3.8 Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka të punësuar të paktën 5 (pesë) punonjës të specializuar/të kualifikuar, të siguruar për 3 (tre) muajt e fundit dhe të kualifikuar me njohuri të kombinuara si mëposhtë, të cilët në mënyrë të kombinuar, të plotësojnë kërkesat për çertifikime profesionale, si më poshtë:

- a. Dy punonjës të çertifikuar si specialist në instaklimin dhe konfigurimin e paisjeve të tipit “Sisteme Parkimi në Rrugë - Parkimetra”, objekt prokurimi, për ploësimin e kriterit OE duhet të paraqesin:
 - Kontrate pune të vlefshme
 - Certifikatat perkatese të trajnimit të leshuara nga kompania prodhuese e mallit objekt prokurimi

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët Ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht:

[..Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se Operatorët Ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie..]

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Duke qenë se objekt-prokurimi është një projekt i teknologjisë së informacionit (T.I.K) nisur nga objekti i prokurimit dhe natyra e kontratës që do të prokurohet, kërkesa për staf të diplomuar ose/dhe të çertifikuar në fushat e sipërpërmendura, për të cilat kërkohet niveli i tyre profesional lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar nga prodhuesi për mallin objekt prokurimi, ku autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Autorizimi duhet të jetë origjinal i përkthyer dhe/ose fotokopje e noterizuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që janë të autorizuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për tregtimin e mallit dhe vendosjen e mallrave objekt prokurimi. Në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor ka garanci që po hyn në marrëdhënie kontraktuale me një operator ekonomik serioz në treg, që ka autorizim për kryerjen e aktivitetit objekt prokurimi dhe siguron lidhjen përkatëse me subjektin që ka dhënë autorizimin. Kriteri i përcaktuar është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi ose distributori.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një dekarate i cili merr persiper inastlimin dhe konfigurimin e sistemit dhe paisjeve objekt prokurimi.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës” Për këtë qëllim është kërkuar që të paraqitet një deklaratë e Operatorëve Ekonomikë ofertues, të cilët marrin përsipër të kryejnë inastlimin dhe konfigurimin e sistemit dhe paisjeve objekt prokurimi.

2.3.12 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një dekarate i cili merr persiper garancine e mallrave objekt prokurimi për 1 (një) vit.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës” Për këtë qëllim është kërkuar që të paraqitet një deklaratë e Operatorëve Ekonomikë ofertues, të cilët marrin përsipër të kryejnë cdo rregullim ne rast defekti gjate periudhes se garancise se mallrave objekt prokurimi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm, i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve të teknike në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar)

<u>1. ZGJIDHJA E MENAXHIMIT TË PARKIMIT NË RRUGË ME ANË TË PARKIMETRAVE</u>	11
<u>2. Arkitektura e parkimetrit</u>	12
<u>2.1 Specifikimet teknike te parkimetrit</u>	12
<u>2.2 Struktura dhe pjesët përbërëse të parkimetrit</u>	15
<u>2.2.1 Paneli diellor - Karikimi</u>	15
<u>2.2.2 Ndarja e sipërme teknike - Paneli i përdoruesit dhe nënsistemi</u> ..	15
<u>2.2.2.1 Ekрани dhe paneli me prekje</u>	16
<u>2.2.2.2 Modemi LTE (4G) dhe kartë marrësi GPS</u>	17
<u>2.2.2.3 Grupi i pranimit të monedhave</u>	17
<u>2.2.2.4 Pagesat elektronike POS dhe RFID</u>	18
<u>2.2.2.5 Printeri</u>	19
<u>2.2.2.6 Ushqimi me energji elektrike - Bateria</u>	20
<u>2.2.3 Ndarja e poshtme teknike - kasaforta</u>	20
<u>2.2.3.1 Software – Hardware</u>	21
<u>2.2.3.2 Brava elektronike dhe mekanike</u>	21
<u>2.2.4 Gjenerimi i alarmeve të parkimetrit</u>	22
<u>2.2.4.1 Konfigurimi i biletës së parkimit</u>	22
<u>2.2.4.2 Sinkronizimi i kohës</u>	23

<u>2.2.4.3</u>	<u>Tërheqja - Nxjerrja e parave të xhiros</u>	23
<u>2.2.5</u>	<u>Funksionaliteti i parkimetrit</u>	24
<u>2.2.5.1</u>	<u>Zgjatje e orës së parkimit</u>	24
<u>2.2.5.2</u>	<u>Pagesa e gjobave</u>	25
<u>2.2.5.3</u>	<u>Tarifa shtesë</u>	25
<u>3.</u>	<u>PËRSHKRIMI I SOFTWAREVE TË MENAXHIMIT TË PARKIMETRAVE</u>	25
<u>3.1</u>	<u>Qendra e kontrollit - sistemi i centralizuar</u>	26
<u>3.1.1</u>	<u>Siguria dhe Mbrojtja e Privatësisë</u>	26
<u>3.2</u>	<u>Lidhja me parkimetrat</u>	26
<u>3.2.1</u>	<u>Transferimi i të dhënave</u>	27
<u>3.3</u>	<u>Aplikacioni softuer i platformës</u>	27
<u>3.3.1</u>	<u>Identifikimi në software</u>	28
<u>3.3.1.1</u>	<u>Ndërfaqja Hartografike</u>	28
<u>3.3.1.2</u>	<u>Informacioni në formë tabelare</u>	30
<u>3.3.2</u>	<u>Parametrat dhe konfigurimet</u>	30
<u>3.3.2.1</u>	<u>Cilësimet e attributeve</u>	31
<u>3.3.2.2</u>	<u>Konfigurimet</u>	31
<u>3.3.2.3</u>	<u>Loget e ngjarjeve</u>	32
<u>3.3.3</u>	<u>Transaksionet – pagesat</u>	32
<u>3.3.4</u>	<u>Tërheqja - Nxjerrja e parave të xhiros</u>	33
<u>3.3.5</u>	<u>Alarmet</u>	33
<u>3.3.6</u>	<u>Tarifat</u>	33
<u>3.3.7</u>	<u>Raportet - Statistikat</u>	34
<u>3.4</u>	<u>INTEGRIMI ME APLIKACIONIN TIRANA PARKING</u>	35

1. ZGJIDHJA E MENAXHIMIT TË PARKIMIT NË RRUGË ME ANË TË PARKIMETRAVE

•
Arkitektura e përgjithshme e sistemit të propozuar të menaxhimit të parkimit në rrugë me anë të parkimeve është paraqitur si më poshtë vijon:

-
- Sistemi i menaxhimit duhet të jetë në një server web, në të cilin duhet të jetë instaluar sistemi operativ dhe softueri aplikativ për menaxhimin e parkimeve. Ai gjithashtu duhet të përfshijë bazën e të dhënave relacionale të përdorur për ruajtjen e të dhënave dhe konsultimet historike.
- Komunikimi midis parkimit dhe serverave duhet të kryhet nëpërmjet një lidhjeje interneti mbi një kanal të mbrojtur HTTPS. Për këtë qëllim, parkimet duhet të kenë një modem 4G LTE dhe/ose priza LAN-Ethernet (për lidhje të mundshme me fibër).
- Ky kanal komunikimi me parkimet duhet ti lejojë serverit të kryejë konfigurimin në distancë të pajisjeve, si psh:
 - Tarifat për orë
 - Të dhënat për t'u printuar në biletë (p.sh. emri i parkimit, adresa, tekstet e personalizuara, etj.)
 - mesazhe me tekst për informim për publikun
 - Data dhe ora (sinkronizimi i orës)
 - Mundësi për përditësime të softuerit
-

- Meqenëse komunikimi duhet të jetë i dyanshëm, parkimetri duhet të dërgojë në kohë reale te serveri backoffice:
- - Të dhëna në lidhje me transaksionet e kryera dhe tërheqjet e xhiros
 - Statusi i funksionimit, duke përfshirë çdo defekt të diagnostikuar dhe statusin e baterisë.
 - Prania e çdo alarmi paralajmërues, si dera e hapur, fundi i rrotullës së letrës, mbushja e arkës së lekëve.
-
- Të gjitha të dhënat e aplikacionit duhet të shikohen dhe përpunohen drejtpërdrejt nga serveri i backoffice.
-
- Për më tepër, serveri duhet të dërgojë të gjitha të dhënat e marra nga matësit e parkimit në sisteme të tjera të jashtme të palëve të treta. Shkëmbimi duhet të bëhet duke përdorur teknologji standarde industriale, të tilla si protokoli HTTPS dhe/ose Shërbimet Ueb / API-REST.

2. Arkitektura e parkimit

2.1 Specifikimet teknike te parkimit

Karakteristikat mekanike	
Struktura	Çelik inox ose ekuivalent minimalisht 3mm AISI 304, i lyer me pluhur epoksi të jashtëm ose ekuivalent dhe trajtim kundër grafitit.
Ndërtimi	Dy ndarje me akses të veçantë: <ul style="list-style-type: none"> • pjesë operative (ndërfaqja e përdoruesit dhe elektronika) • kasafortë me kuti monedhash dhe lidhje elektrike / bateri
Vlerësimi i mbrojtjes IP	Pluhuri dhe uji minimalisht IP54
Temperatura e funksionimit	- 20°C - +55°C
Temperatura e ruajtjes	- 25°C - +70°C
Lagështia relative (jo kondensuese)	Maksimumi 97% në 50°C
Ndërfaqja e përdoruesit	
Paneli i përparmë ergonomik	Ndërfaqe përdoruesi e lehtë për t'u përdorur me informacione të kontrolluara nga autoriteti kontrakttor
Zona e informacionit	Zonë e veçantë e mbrojtur për vendosjen e njoftimeve/etiketave të personalizuar nga A.K

	Prania LED për ndriçim shtesë natën
Ekрани dhe paneli me prekje	Moduli TFT-LCD minimalisht 7,0" me ngjyra i përbërë nga një panel IPS LCD 1024×600 piksel dhe 16,7 milion ngjyra, 1000 cd/m2 ndriçim i pasmë LED dhe paneli me prekje kapacitiv, për të shfaqur datën, kohën, statusin e funksionit, udhëzimet, tarifat dhe ekzekutimin e komandave të përdoruesit .
Butonat	Lloji antivandal: <ul style="list-style-type: none"> • Butoni i gjelbër për të konfirmuar funksionimin • Butoni i kuq për anulimin e operacionit në vazhdim
Lexues monedhash	Mbështetje e të gjithë monedha të ndryshme shqiptare dhe/ose euro të konfigurueshme
Lexuesi i kartave POS EMV / RFID	Disa opsione të disponueshme: <ul style="list-style-type: none"> ▪ kartat bankare (ATM) dhe kartat e kreditit me kontakt ose me pin pad ▪ Kartat pa kontakt (NFC) ▪ Kartat Mifare 13,56 Mhz ISO 14443 A/B RFID
Printer termik	Lloji profesional, me prerës vetë-mprehës – kapaciteti i rrullit mbi 3500 bileta (me letërën e rekomanduar 80 g/m2) ose mbi 5000 bileta (me letër 50-60 g/m2). Printim për tekstin/logot/barkodet 1D, 2D - QRCode. Prania e sensorit të fundit të letrës
Kthimi i biletës	Ndarje specifike për grumbullimin e faturave me mbrojtje ndaj motit të keq dhe vandalizmit
Kthimi i monedhave	Ndarje specifike për grumbullimin e monedhave me mbrojtje nga moti i keq dhe vandalizmit
Karakteristikat teknike	
Procesori	Procesor minimalisht ARM® Cortex™-A7 me shumë qëllime 500 MHz ARM® Cortex™-A7
RAM	Memorie RAM minimalisht 512 MB DDR3L
Memorje	Minimalisht 4GB eMMC memorie flash solid state
Skeda e sensorëve të CPU-së	<ul style="list-style-type: none"> • Sensori i dritës për rregullimin automatik të ndriçimit të ekranit • Sensori i temperaturës dhe lagështisë • Moduli i zbulimit GPS multi-directional • Sensori i hapjes së derës së sipërme • Sensori i hapjes së derës së poshtme • Sensori i nxjerrjes së kasetës së monedhës
Ndërfaqet bordi kryesor	<ol style="list-style-type: none"> 1. Minimalisht 4 porta të tipit minimalisht USB 2.1 2. Minimalisht LAN me 2 porta 10/100 Mb 3. Minimalisht 4 hyrje dixhitale gjenerike dhe 4 dalje 4. Minimalisht 2 porta seriale shumë standarde RS232, RS485, RS422 5. Minimalisht Lexues i kartave të memories usd - i zgjerueshëm në 128 GB
Sinjalizuesit	<ul style="list-style-type: none"> • Minimalisht 1 LED RGB me 3 ngjyra, e kuqe, jeshile, blu për sinjalet e statusit dhe

		funksionimit
		<ul style="list-style-type: none"> • Minimasht pajisje piezoelektrike akustike - sinjalizuese
Ora kalendarike		<ul style="list-style-type: none"> • E përhershme, e sinkronizuar automatikisht me kohën e sistemit dhe e përditësuar me kohën e marrësit GPS dhe me lidhjen me internetin nëpërmjet modemit LTE (modaliteti NTP).
Sistemi operativ		<ul style="list-style-type: none"> • Windows/Linux/etj.
Ushqimi		Kapaciteti i panelit diellor 20 Watt – 90° i rregullueshëm Nga rrjeti duke përdorur kompletin e furnizimit me energji 12/24 - opsionale
Bateritë rikarikueshme	e	Bateri minimalisht xhel plumbi 12V – 33Ah rikarikohe me panel diellor
Përthithja minimale		< 3 mA
Përthithja maksimale		400 mA
Operacioni		
Komunikimi		Në mënyrë të pavarur nga lokale ose rrjeti duke përdorur: <ul style="list-style-type: none"> • LTE 4G modem • Kabllo Ethernet
Programimi		Nëpërmjet aplikacionit lokal në ndërfaqen me prekje ose në distancë me serverin e menaxhimit

Miratimi

Parkimetri duhet të jetë i certifikuar sipas standarteve europiane CE dhe të përputhet me specifikimet më të fundit të rregullores UNI EN 12414:2020 (të lëshuar nga një laborator i certifikuar) si dhe duke iu referuar UNI EN 12414:2020.

Shkalla e mbrojtjes IP - Rezistenca IK - siguria elektrike

Parkimetri duhet të jetë i mbrojtur nga pluhuri dhe spërkatjet e ujit, me një vlerësim IP54, në përputhje me standardin e ri EN 60529, duke i rezistuar goditjeve me një shkallë mbrojtjeje IK 9 bazuar në standardin e ri EN 62262 dhe të përputhet me standardin e ri për mbrojtje dhe siguria elektrike EN IEC 62368-1 Pajisje audio/video.

Dimensionet, Estetika dhe Ergonomia

Parkimetri duhet të ketë një dizajn të thjeshtë dhe të lehtë, i cili përshtatet me çdo kontekst urban. Duhet të jetë e dizenuar që opsionalisht të zgjidhet ngjyra nga Autoriteti Kontraktor dhe të dallohet pamja midis trupit dhe panelit të përparmë.

Dimensionet e parkimetrit dhe vendndodhja e moduleve të saj duhet të jetë krijuar për të maksimizuar ergonominë e ndërfaqes së përdoruesit. Të gjitha pjesët që kërkojnë ndërveprim me përdoruesit duhet të gjenden në pozicionin e përshtatshëm sipas specifikimeve EN 301549:2018, të referuara në UNI EN 12414:2020, në lidhje me dispozitat në lidhje me lartësitë dhe aksesin për personat me aftësi të kufizuara (instrumente deri në maksimum 1220 mm nga toka).

2.2 Struktura dhe pjesët përbërëse të parkimetrit

Parkimetri duhet të përbëhet nga një strukturë e përbërë minimalisht nga seksionet kryesore të mëposhtme:

- **Paneli diellor**
- **Moduli i sipërm**
 - paneli i përparmë i përdoruesit
 - komponentët elektrike-bateri dhe elektronikën e kontrollit
- **Moduli i poshtëm**
 - kasafortë / kuti monedhash

Struktura mbështetëse ka funksionin e mbajtjes dhe mbrojtjes së hapësirës të parkimetrit. Duhet të jetë bërë minimalisht prej çeliku inox AISI 304 dhe/ose ekuivalent me karakteristika të larta të rezistencës dhe korrozionit atmosferik, pandryshueshmërisë dhe riciklimit.

Në pjesën e përparme duhet të ketë derën e sipërme për hyrje në ndarjen teknike (komponentët elektronikë dhe elektrike) dhe derën e poshtme për hyrjen në kasafortë dhe kutinë e parave.

Dy ndarjet e sipërme dhe të poshtme duhet të kenë dy sisteme të veçanta kyçjeje, mekanike ose ndoshta të integruara me një bllokim elektronik për mbrojtjen e objekteve me vlerë.

2.2.1 Paneli diellor - Karikimi

Parkimetri duhet të jetë i pajisur me një panel diellor me efikasitet të lartë dhe një bateri karikuese.

Karakteristika e panelit diellor duhet të rregullohet me 90° dhe të pjerrët me 25° për të marrë performancën dhe efikasitetin maksimal (deri në 20 W) bazuar në llojin e instalimit.

2.2.2 Ndarja e sipërme teknike - Paneli i përdoruesit dhe nënsistemi elektronik

Paneli i përdoruesit

Paneli i përdoruesit duhet të ketë të gjitha mjetet e dobishme për përdoruesin për të kryer operacionet e parkimit ose shërbimet e disponueshme:

- Ekran me prekje minimilasht 7" me ngjyra
- 2 butona me ngjyra ndërkombëtare për funksione të ndryshme
 - E gjelbër: konfirmo
 - E kuqe: anulo
- Sinjalizim LED
- pagesa me monedhë
- Pagesa EMV-NFC POS,
- Lexuesi i kartave Mifare RFID

Paneli i përdoruesit duhet të ketë grafika që ofrojnë informacionin standard të nevojshëm për përdorimin e saktë të parkimetrit. Paneli i përdoruesit duhet të ketë ngjyra të ndryshme në bazë të kërkesës së autoritetit kontraktor.

Ikonat dhe piktogramet duhet të jenë rezistente ndaj agjentëve atmosferikë dhe vandalizmit dhe të tregojnë qartë metodat e pagesës së parkimit (monedha, karta, etj.) dhe butonat për konfirmimin dhe anulimin e operacioneve (jeshile dhe e kuqe).

Dyert duhet të mbrojnë pajisjen nga agjentët atmosferikë, ti rezistojnë goditjeve dhe duhet të jetë të strukturuar në atë mënyrë që të kufizojnë sa më shumë çdo formë vandalizmi dhe thyerjeje.

2.2.2.1 Ekрани dhe paneli me prekje

Parkimetri duhet të jetë i pajisur me një modul video të përbërë nga:

- Ekran me panel minimalisht TFT-LCD 7,0 inç, 1024 × 600 piksele dhe 16,7 milion ngjyra
- Ndriçim LED me ndriçim minimalisht 1000 cd/m²
- Panel me prekje me multipoint e multi-touch

Moduli i ekranit dhe prekjes duhet të ketë një ndërfaqe e plotë për shikimin dhe futjen e komandave për të gjitha funksionet dhe operacionet e zbatuara për përdoruesit dhe punëtorët e mirëmbajtjes. Ekрани me zonën e tij vizuale 7 inç, rezolucion të lartë dhe ndriçim të lartë të dritës së prapme (rregulluar automatikisht në bazë të dritës së ambientit) duhet të garantojë shikueshmëri të plotë në të gjitha kushtet me fleksibilitet të konsiderueshëm në sasinë e informacionit që do të shfaqet.

Ekрани duhet të ketë standart mbrojtjeje nga vandalizmi (mbrojtja IK10) dhe nga agjentët atmosferikë duke pasur një sistem efektiv kundër gërvishtjeve midis vetë ekranit dhe pjesës në kontakt me pjesën e jashtme me rezistencë të garantuar ndaj prishjes nga rrezet UV.

Me panelin me prekje me rezolucion të lartë, duhet të disponohet një ndërfaqe e plotë e inputit të komandave që përshtatet me paraqitjen e ekraneve të ndryshme të tastierës virtuale Qwerty. Duke përdorur tastierën virtuale duhet të mundësohet që përdoruesi të fusë të dhëna të tilla si targa, numri i telefonit ose hapësira e parkimit dhe punonjësit e mirëmbajtjes të kryejnë veprimet e konfigurimit të parkimetrit.

Mesazhet që shfaqen në ekran për të informuar dhe drejtuar përdoruesin në kryerjen e operacioneve të ndryshme deri në pagesën dhe lëshimin e biletës së parkimit duhet të shprehen në disa gjuhë të zgjedhura dhe që mund të shtohen sipas nevojave (shqip, italisht, anglisht.). Pranë ekranit duhet të ketë minimalisht një dritë sinjalizuese, e dukshme nga të paktën 5 metra, e cila tregon statusin e pajisjes.

Drita duhet të marrë ngjyra të ndryshme:

- E KUQE: jashtë shërbimit - Mosfunksionim total i parkimetrit;
- E VERDHA: Para-alarmi (letër / bateri e ulët);
- E GJELBËR: funksionim i rregullt;

2.2.2.2 Modemi LTE (4G) dhe kartë marrësi GPS

Karta e modemit duhet të jetë e pajisur me një modul 4G LTE cat. 1 me marrës GPS të integruar (Glonass, Galileo, Bendo), pra në bord të ketë një vend për kartë nano SIM dhe konektorë FAKRA për antenat GPS dhe LTE.

Nëpërmjet modemit 4G LTE operatori mund të monitorojë nga distanca rrjetin e parkimetrit si për sa i përket funksionimit të tyre (alarmet, gjendjet, grumbullimi i të dhënave statistikore në lidhje me përdorimin e parkimetrit) ashtu edhe për modifikimin e parametrave të konfigurimit, shtimin e funksionalitetit dhe përditësimeve.

Lidhja e modemit LTE duhet të bëhet duke përdorur antenën e duhur me metodat e marrjes-transmetimit të parashikuara nga standardi LTE 4G.

Moduli GPS garanton pozicionin e saktë të parkimetrit gjatë instalimit si dhe siguron siguri shtesë në rast të thyerjes/heqjes së të gjithë strukturës së tij.

2.2.2.3 Grupi i pranimit të monedhave

Grupi i pranimit të monedhave pasqyron kushtet e kërkuara, duhet të ketë performancë të lartë dhe të përbëhet nga komponentët e mëposhtëm:

1. Sistemi anti-vjedhje me bllokues dhe sensor afërsie
 - Sensori i hyrjes së monedhës duhet të jetë i aftë për të pranuar vetëm një monedhë në të njëjtën kohë
 - mos të lejojë futjen e trupave ose lëngjeve të huaja
2. Përzgjedhës monedhash
 - Duhet të shmangi bllokimet përmes funksioneve automatike të heqjes së monedhave
 - Duhet të njohi dhe pranojë të gjitha monedhat e kërkuara shqiptare dhe euro me aftësinë për të lexuar deri në 3 monedha në sekondë.
3. *Kasa paraparake e mbledhjes së shumës së tarifës*

- Mbledhja paraprake e depozitës së monedhës përpara konfirmimit të pagesës (të pranojë mbi 30 copë monedha)

Pranuesi i monedhës duhet të jetë krijuar për të testuar madhësinë, formën dhe materialin e objektit që do të futet. Nëse objekti që tentohet të futet në hapësirën e monedhave nuk është monedhë metalike, kjo e fundit duhet të mbetet e mbyllur. Në këtë rast, bllokuesit mekanikë duhet të çaktivizohen dhe fillon një procedurë e rikuperimit të gabimeve. Më pas pajisja bën një sërë përpjekjesh për të verifikuar qëndrueshmërinë e pengesës (objektit të huaj). Nëse pengesa (objekti) nuk hiqet, makineria duhet të marri masa automatike, nga kalimi në gjendjen jashtë shërbimit, deri te gjenerimi i një alarmi në distancë në sistemin qendror.

Në rast të futjes së një objekti të parregullt, pajisja duhet të kalojë në bllokim.

Pas pranuesit të monedhave, tuneli zbritës që çon monedhat në kuti duhet të ketë pengesa të brendshme, të pozicionuara në mënyrë që të shmangët mundësia e “peshkimit” nga kutia tek kasaforta e sipërme. Struktura duhet të jetë si një lloj sifoni që të mos lejojë këto veprime.

Besueshmëria e sistemit të leximit të monedhave duhet të jetë 99,00% me një MTBF (Mean Time Between Failures) të barabartë me 2 milion monedha.

2.2.2.4 PAGESAT ELEKTRONIKE POS DHE RFID

Parkimetri duhet të jetë i pajisur me një sistem pagese elektronike EMV (Europay, Mastercard, Visa) dhe NFC (Near Field Communication) i cili lejon pagesat pa kontakt.

POS ContactLess pin on glass

Parkimetri duhet të ketë modul të aktivizuar për pagesat NFC me konfirmim të shpejtë identifikimi në mjedise të pambikëqyrura dhe me një vëllim të lartë transaksioni për pagesa të sigurta dhe të shpejta pa kontakt të të gjitha sistemeve të pagesave elektronike VISA, MASTERCARD, PayPass, VisaPayWave dhe e-Wallet, Google Pay, Apple, etj.

POS-i duhet të ketë një ekran LCD me prekje i cili lejon që PIN-i të futet në xhami në rast të transaksioneve që tejkalojnë kufijtë e shumave të parashikuara në modalitetin pa kontakt (p.sh. më shumë se 2500 lekë ose 5000 lekë)

Karakteristikat minimale teknike që duhet të ketë moduli i pagesave me kartë janë:

- Këllëf antivandalizëm i aftë për t'i bërë ballë një goditjeje deri në 10 xhaul (mbi 170 kg) - IK09
- I papërshkueshëm nga moti - duhet të sigurojë mbrojtje të nivelit të lartë kundër pluhurit, lëngjeve dhe substancave të tjera të dëmshme, sipas standartit IP65
- Informacioni i gjendjes vizuale nëpërmjet ekranit LCD me ngjyra minimalisht 3,2".
- Prania e paralajmërimit akustik BUZZER për të sinjalizuar rezultatin e operacioneve
- Në përputhje me Certifikimin CE dhe konsorciumin ATM (standardi CB2)
- Siguria

- PCI PTS 5.X i miratuar, SRED, plotëson kërkesat EMV L1 dhe L2
- 2 module SAM (Secure Access Module)
- Përbush standardet EVA (European Vending Association) dhe EPS (Earning per Share)
- Në përputhje me standardin EN 62368 ndaj zjarrit dhe tymit.
- Mjedisore
 - Temperaturat e funksionimit -30° deri në 70° C (-22° deri në 158° F)
 - Temperaturat e ruajtjes dhe magazinimit, lagështia relative 10% deri në 90%, pa kondensim

Komunikimi i modulit POS duhet të përdori modemin 4G LTE (ose LAN) të pranishëm në parkimetër pa pasur nevojë për karta SIM shtesë.

POS duhet të parametrizohet dhe përditësohet jo vetëm në nivel lokal nga ndërfaqja e parkimetër, por edhe nga distanca direkt nga platforma qendrore.

Të gjithë терминаlet konfigurohen drejtpërdrejt me bankën referente të kërkuar nga institucioni pa ndërmjetës dhe komisione shtesë.

POS-i duhet të konfigurohet dhe përditësohet jo vetëm në nivel lokal direkt nga ndërfaqja e parkimetër, por edhe nga distanca nga platforma qendrore.

RFID - kartat Mifare

Parkimetri duhet të jetë gjithashtu të ketë mundësinë e shtimit të modulit me një lexues RFID të afërsisë për leximin e kartave të mikroçipit Mifare për të qenë në gjendje të kryejë pagesa dhe/ose të njohë personelin operativ për aktivitetet e mirëmbajtjes/kontrollit.

2.2.2.5 Printeri

Parkimetri duhet të jetë i pajisur me një printer termik profesional me jetëgjatësi:

- Teh vetë-mprehës
- Prerje totale ose e pjesshme – min. deri në 1,500,000 prerje
- Sensori i fundit të letrës
- Orientimi horizontal/vertikal
- Rezolucioni minimal 8 dot/mm (203 dpi)
- shpejtësia minimale 150 mm/sek
- Printim i tekstit/logot/barkodet 1D (UPC-A, UPC-E, JAN13, JAN8, CodeBar, Code39, CODE93, Code128) dhe 2D (kodi QR, MaxiCode, DataMatrix, MicroPDF417, PDF417),
